

UDHËZUES PUNËSIME TË PËRKOOSHME NË SEKTORIN E NDËRTIMTARISË

Punëmarrësit, të cilët kanë punuar rregullisht në ndërtimtari nga mosha 40 deri në atë 60 vjeçare kanë të drejtë të marrin një pension kalimtar nga ana e fondacionit FAR, nëse plotësojnë disa kushte të caktuara

Informacione mbi këtë çështje gjenden në faqen www.far-suisse.ch/leistungen.

Për të verifikuar nëse ju takon pensioni në fjalë fondacionit FAR i duhet një dokumentacion i pandërprerë i marrëdhënies suaj të punës nga mosha 40 deri në atë 60 vjeçare.

Punësimet e mundësuarra nëpërmjet firmave ndërmjetësuese shpeshherë shfaqin parregullsi. Për këtë arsye fondacioni FAR ju rekomandon në mënyrë të veçantë të ruani me kujdes dokumentacionin e plotë të punësimit të 20 viteve të fundit para mbushjes së moshës të pensionit, nëse punësimi mundësohet nëpërmjet firmave ndërmjetësuese.

Dokumentacioni në fjalë përfshin:

- të gjitha kontratat e punës (Einsatzvertrag)
- të gjitha listat e pagave (Lohnabrechnung)
- të gjitha vërtetimet e pagave (Lohnausweis)

Paraqitja e këtij dokumentacioni do të bëjë të mundur shqyrtimin e shpejtë të kërkesës suaj për marrjen e pensionit në fjalë.

Fondacioni FAR ju falenderon për bashkëpunimin.